



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 17, datë 25.02.2020.

**Për**

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Vau-Dejës, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e **z.Çesk Pal Daja** banore i fshatit Hajmel të Njësisë Administrative Hajmel të Bashkisë Vau-Dejës banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri me dt.10.02.2020 nga Buxheti i Bashkisë i vitit 2020 si dhe Buxheti i Vitit 2020 në Ministrinë e mbrojtjes, programi “Mbrojtja Civile”.

Shkak i dëmtimit të kësaj shtëpie është djegia nga zjarri, e vlerësuar nga specialistet e M.Z.SH-së (zjarrfikësve).

**Baza Ligjore**

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji për prefektin Nr.107/2018, Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen Civile , VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 i KM “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016 ,në shkresën **Nr. 287 prot, datë 14.02.2017** të Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të banesave (drejtoria teknike) dërguar Këshillit të Qarkut Shkodër për çmimet për zëra punimesh të vitit 2016, Shkresa Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, pas diskutimit u miratua sipas nenit 55 pika 3 e Ligjit 139/2015,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e familjes së shtetasit **Çesk Pal Daja** banorë i Bashkisë Vau-Dejës për mbështetje financiare të tij, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri me dt.10.02.2020.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau-Dejës.